



Република Северна Македонија

Министерство за култура

- Сектор за следење, развој и логистичка поддршка
- **Njwsia pwr çmime shtetërore**

Në bazë të nenit 19 paragrafi 1 alinea 1 të ligjit për çmime shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” бр. 52/06, 54/07, 74/12, 99/18 dhe 98/19) dhe Rregullores për punë të Këshillit për ndarjen e çmimit shtetëror „Meto Jovanovski “ nr. 17-11997/1 prej 12.10. 2021, Ministria e Kulturës shpall

KONKURS

PËRGATITJE TË VENDIMIT IDEOR ARTISTIKO- GRAFIK PËR DIPLOMË DHE PLAKATË PËR ÇMIMIN SHTETËROR „METO JOVANSKI”.

I. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR KONKURSION

1. Furnizues i lëndës së Konkursit është Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: furnizues).

2. Lëndë e konkursit – Përgatitja e një vendimi ideor artistiko-grafik për diplomë dhe plakatë për çmim shtetëror „Meto Jovanovski”.

3. Përshkrim të vendimit artistiko-grafik: me çmimin shtetëror „Meto Jovanovski” jepet mirënjohja më e lartë për arritje shumëvjeçare në fushën e promovimit, mbrojtjes dhe avancimit të të drejtave njerëzore.

Diploma dhe plakata shkruhen në gjuhën maqedone dhe me shkrim kirilik.

II. KUSHTE DHE KARAKTERISTIKA TË KONKURSIT

4. Vendimi ideor artistiko-grafik për diplomë dhe plakatë për çmimin shtetëror „Meto Jovanovski” duhet t'i ketë karakteristikat vijuese:

- për diplomën:

a) të përmbajë: „titull e çmimit, emër dhe mbiemër /titullin e fituesit /fituesve, titullin e realizimit dhe titullin e fushës, territorin, veprimtarinë në të cilën është arritur realizimi. Diploma verifikohet me vulë, dhe stemën e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Këshili për ndarjen e çmimit shtetëror „Meto Jovanovski” dhe ajo nënshkruhet nga kryetari i Këshillit”;

b) diploma është me dimensione: gjatësi 40 cm dhe gjerësi 28 cm;

- për plakatë:

a) përmban vendim artistik dhe elemente elementare nga teksti i diplomës;



Република Северна Македонија

Министерство за култура

- **Сектор за следење, развој и логистичка поддршка**
- **Njwsia pwr çmime shtetërore**

б) plakata është me dimensione 7,5 x 7,5 cm.

Diploma dhe plakata duhet ta përmbajnë të njëjtin motiv artistik.

-Autorët e vendimeve ideore artistiko-grafike për diplomë dhe plakatë të çmimit shtetëror „Meto Jovanovski” janë të lirë në shprehjen e tyre. Vendimi artistiko-grafik duhet të shpreh thelbin e çmimit shtetëror „Meto Jovanovski” dhe përshkrimin e tij të përmendur në pikën 3.

- Vendimet e dërguara ideore artistiko-grafike duhet të jenë në formë digjitale dhe formë të shtypur ose në ndonjë tjetër lloj të formës grafike 1:1, me hyrje tekstuale me arsyetim për konceptin ideor.

- Vendimi ideor duhet të jetë original dhe deri më tani i papërdorur.

III.TË DREJTË PJESËMARRJE NË KONKURS

5. Konkursi është publik dhe anonim për pjesëmarrësit. Të drejtë pjesmarrje në Konkurs kanë të gjithë personat fizikë dhe juridikë.

IV. MËNYRA E DORËZIMIT DHE AFATI I PARAQITJES SË MATERIALEVE

6. Me shtresë të padukshme dhe të vulosur, të siguruar gjatë transportit, me mbishkrimin Konkurs për përgatitjen e vendimit ideor artistiko-grafik për diplomë dhe plakatë për çmimin shtetëror „Meto Jovanovski”, me rekomandim të qartë të shkruar: **„Mos e hap!”** dhe të shenjuar me shifër (pesë simbole, shkronja ose numra ose kombinim), duhet të përmbajnë:

1. Zarf të veçantë të mbyllur për punimin e konkursit ideor/ dhe artistik/dhe-grafikor/dhe vendim /e) të dorëzuar në formë digjitale dhe të shtypur, me mbishkrimin Konkurs për përpunimin e vendimit ideor artistiko-grafik për diplomë dhe plakatë për çmimin shtetëror „Meto Jovanovski”, me rekomandim të shkruar qartë: **„Mos e hap!”** dhe të shenjuar me të njëjtën shifër dhe

2. Zarf të veçantë të mbyllur me të dhëna për autorin (rruga, numri, vendi, qyteti, telefoni për kontakt dhe e-adresa) me rekomandim të qartë: „Mos e hap!” dhe të shenjuar me shifrën e njëjtë.

7. **Konkursi zgjat nga 1.11..2021 deri 10.11.2021, gjegjësisht afati fundit për dorëzimin e punimeve për konkursin është 10 nëntori 2021 deri më 16:00** në arkivin e Ministrisë së Kulturës ose me postë në adresën: rruga „Gjuro Gjakoviq “ nr. 61, Shkup. Me dorëzimin e materialit për konkursin në/deri tek Ministria e Kulturës, llogaritet që secili pjesëmarrës i pranon kushtet e Konkursit.

V. ÇMIME DHE VLERA TË KONKURISIT



Република Северна Македонија

Министерство за култура

- **Сектор за следење, развој и логистичка поддршка**
- **Njwsia pwr çmime shtetërore**

8. Vlerësimi i punimeve do ta bëj komision në bazë të kushteve dhe karakteristikave të këtij konkursi:

9. Në konkurs do të ndahet një çmim dhe një blerje në vlerat vijuese të neto shumave:

- çmimi _____ 40.000,00 denarë;

- blerja _____ 20.000,00 denarë.

VI. INFORMIM TË REZULTATEVE TË KONKURSIT

10. Punimet të cilët nuk i përmbajnë të gjitha elementet e përshkruara në kreun e **II. Kushte dhe karakteristika të konkursit** dhe në kreunj **IV. Mënyra e dorëzimit dhe afati i paraqitjes e vendimeve ideore**, gjegjësisht jokomplete, jo në kohë dhe në mënyrë joadekuate të dorëzuara, nuk do të jenë lëndë për shqyrtim të komisionit. Komisioni do ta bëj notimin dhe do t'i shpall rezultatet e konkursit në afat prej **10** ditësh në mbarim të konkursit. Punimet nuk kthehen.

11. Ministria e Kulturës do të blejë punimet të cilat i plotësojnë kushtet e konkursit në tërësi dhe do të bëj marrëveshje autoriale për shfrytëzim të veprës, gjegjësisht për bartje të drejtave autoriale të patjetërsueshme për shfrytëzimin e veprës, që do të jenë të rregulluara me marrëveshje

VII. INFORMATA PLOTËSUESE

12. Për qartësime plotësuese, të gjithë të ineteresuariat mund të drejtohen tek përgjegjësi zyrtar shtetëror në Ministerinë e Kulturës, Shemi Memishi dhe Femi Ademi në numrin e telefonit 02 3 207- 438

Ministria e Kulturës